

**KODE TË TRASHËGIMISË KULTURORE
NË DRAMATURGJINË SHQIPE**

Autori: Anxhela Hoxha (Çikopano)
Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Stefan Çapaliku



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

SHKOLLA DOKTORALE “ETNOLOGJI/ FOLKLOR”

Tezë në kërkim të gradës shkencore

“DOKTOR”

Fusha ETNOLOGJI / FOLKLOR

Specialiteti ETNOLOGJI

**Tema: KODE TË TRASHËGIMISË KULTURORE
NË DRAMATURGJINË SHQIPE**

Autor

Anxhela Hoxha (Çikopano)

Drejtues shkencor

Prof. Dr. Stefan Çapaliku

Tiranë, më ____/____/2019

3.5.2. PENA E KOLË JAKOVËS KRIJON TOKA JONË NË FRYMËN E AGJIT-PROPAGANDËS

Kolë Jakova lindi në Shkodër më 1917¹ dhe pavarësisht se nuk thuhet kudo, vitet e para të shkollimit, i kreu në *Kolegjin Françeskan*². Këtu duhet të ketë rënë në dashuri me teatrin, pasi siç e kemi thënë, nxënësit e kolegjeve françeskane vinin vazhdimisht shfaqje në skenë. Këtë ma konfirmon deri diku edhe një pohim i autorit vetë në vitin 1979, pavarësisht se, natyrisht, ai nuk e përmend emrin e gjimnazit: *Kur isha në gjimnaz, pata shkruar një farsë me një akt, në të cilën vihej në lojë një tregtar, i cili e rripte popullin e varfër. E kujtoj me mall edhe sot gëzimin, që kisha kur e pashë të realizuar në skenën e gjimnazit nga shokët e mi. Një gëzim të tillë nuk e kam provuar kurrë në jetë*³. Mbase kjo ishte arsyeja pse pas pjesëmarrjes në luftë, ai u zgjodh drejtori i parë i *Teatrit Kombëtar*⁴. Si një prej komunistëve të orëve të para, Kolë Jakova



Figura 14 – Vendi i veprimit ku zhvillohen ngjarjet e *Toka Jonë* dhe vendlindja e Kolë Jakovës

¹ Papagjoni, J. (2011). *Historia e teatrit shqiptar*. Tiranë, Shqipëri: Qendra e Studimeve Albanologjike, fq. 184

² Këtë fakt e kam hasur vetëm në biografinë e tij në: Budini B. "Jetëshkrim" (28.11.2014), referuar më 02.11.2018 https://shkoder.net/kole_jakova/, por e pohon edhe shkrimtari Fadil Kraja, në një dokumentar të Engjëll Ndocaj për Kolë Jakovën, *Kolë Jakova, një penë për të gjithë* https://www.youtube.com/watch?v=f_gUCg1u3To (min 02:38-02:46), referuar më 02.11.2018

³ Jakova K. (1979), *Për dramaturgjinë.. në ndihmë të autorëve të rinj*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia Qendrore e Krijimtarisë Popullore, fq. 117

⁴ Papagjoni, J. (2011). *Historia e teatrit shqiptar*. Tiranë, Shqipëri: Qendra e Studimeve Albanologjike, fq. 67

besonte vërtet në “*arritjet*” e rendit të ri dhe gjithashtu, kishte një penë vërtet të talentuar, dy faktorë këta, që e ndihmuan shumë të krijonte një dramë, e cila i bënte nder agjit-propagandës.

Te **Toka Jonë**, shkruar dhe vënë në skenë më 1954, Kolë Jakova i vë ngjarjet në tetor të vitit 1946, në Breg të Matës, një zonë e juridiksionit të **Kanunit të Lek Dukagjinit**, por në kufi me **Kanunin e Skënderbeut**, të cilët ndahen nga lumi Mat, në bregun verior të të cilit zhvillohen edhe ngjarjet. Vetë autori, duke qenë nga Shkodra, pavarësisht se në qytetet, kanuni nuk zbatohet si në zonat rurale, vjen nga i njëjti shtrat zakonor, kështu që i njeh më së miri, doket zakonore, që ka përdorur në dramë.

Fabula e **Toka jonë** flet për Tuç Makun, një pronar tokash e bagëtish, i cili ka vrarë në pabesi, përmes dikujt tjetër, Gjokën, me të cilin ishte bërë vëllam duke pirë gjak, si duket që t’i çnderonte gruan e t’i merrte tokën Ai i ka rritur fëmijët jetimë, pasi përmes një thashethemi ka arritur t’i bindë njerëzit që Lokja, gruaja e të ndjerit, është e pandershme, ndaj është përzënë nga shtëpia. Në kohën kur fillon tragjedia, po zbatohet reforma agrare dhe Lokja, e lidhur me djalin e saj komunist Murrashin, vjen t’i provojë djalin të madh, Lekë Gjokës se ajo është e pafajshme dhe se çdo mashtrim buron prej Tuç Makut. Ata përpiqen ta bindin Lekën, i cili, është përfshirë në ndarje të padrejtë të tokave, sipas dëshirës së Tuçit e Vatës. Tuçi e ka fejuar Filen, vajzën e Lokes me Vatën, të cilin e mban peng nga një sekret vrasjeje. Murrashi prish edhe këtë fejesë dhe Vata e vret, pastaj vjen të çnderojë ose të vrasë Filen, mirëpo nuk ia del dot mbanë. Tragjedia mbaron kur Murrashin e sjellin në shtëpi dhe Lokja zë mat Tuçin, që ua dorëzon partizanëve e fshatarëve.

Nga kërkimet më rezulton se fara e dramës vjen nga një ngjarje reale, kur më 25 tetor 1946, raportohej se në Breg të Matës kishin pushkatuar një pronar, me qëllimin që t’u fusnin frikën banorëve, të cilët nuk dorëzonin armët, duke përhapur sistematikisht terrorin, që *këta kanë informata dhe të pushkatojnë në vend*¹. Në librin **Për dramaturgjinë... - në ndihmë të autorëve të rinj**, vetë Kolë Jakova tregon se si e ka shkruar **Toka jonë**, po shpesh herë është kontradiktor. Ai thotë se e ka filluar dramën nga dashuria e Files me Vatën, po kur nisi të krijonte shtëpitë e varfra të fshatarëve, befas kuptoi se tema kryesore duhet të ishte reforma agrare dhe se ata duhet të kishin një pronar tokash, që i kishte shfrytëzuar deri në palcë, siç kishte dëgjuar nga fshatarët². Mirëpo, pak më herët, po vetë autori shkruan: *Kishte kohë që më vinte rrotull tema e Reformës Agrare, realizimi i ëndrrës shekullore të fshatarësisë. Bujku i pa tokë u bë me tokë. Kjo temë më pati prekur shumë*³. Nga sa thotë autori, nuk dimë ta ndajmë në nisi nga dashuria e çiftit dhe pastaj doli reforma apo nisi nga reforma. Gjithashtu ai shkruan: *E para, jo çdo gjë që njohim, jep dorë për dramë dhe e dyta, jo çdo gjë që njohim na nxit të krijojmë rreth saj. [...] Dramaturgu duhet të njohë ato ngjarje, ato fabula që i japin mundësi konfliktit të zhvillohet*

¹ N.d (2018) “Po pushkatojmë nga një në çdo fshat, që t’i frikësojmë” botuar në Kujto.al më 23.10.2018, <https://kujto.al/po-pushkatojme-nga-nje-ne-cdo-fshat-qe-ti-frikesojme/> referuar më 02.11.2018

² Jakova K. (1979), *Për dramaturgjinë.. në ndihmë të autorëve të rinj*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia Qendrore e Krijimtarisë Popullore, fq. 120

³ Jakova K. (1979), *Për dramaturgjinë.. në ndihmë të autorëve të rinj*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia Qendrore e Krijimtarisë Popullore, fq. 118

*normalisht drejt zgjidhjes*¹. Pra, është një ngjarje me konflikt të fortë, siç mund të ishte vrasja e pronarit, e cila mund të lidhej fare lehtë me reformën agrare dhe tokën, gjë e provon edhe vetë autori më poshtë, kur tregon për thurjen e fabulës: *Të kuptohemi, babai mund të kishte vdekur edhe në mënyrë të zakonshme, por një vdekje e tillë nuk më jepte dorë për të intriguar më mirë dramën. Arsyeja, pra, që Tuçi e kishte zhdukur babanë e Files ishte çështje toke. Pronarët ishin të pangopur për të zaptuar toka. Ata me intriga të ndryshme i shtinin në dorë parcelat, që kishin rreth tokave të tyre*². Tani, siç e kemi parë më herët gjatë punimit, toka nuk mund të blihej a të shtihej në dorë kaq kollaj e me intriga, në zonat ku funksiononte fisi agnatik dhe kodet zakonore që e qeverisnin, ndaj autori ka spekuluar lirshëm me konceptet e frymëzuara nga ideologjia komuniste mbi figurën e këtij pronari tokash, që kishte merituar vdekjen. Si t'i shpëtojë diçka mes rreshtave, kur flet për përcaktimin e vendit dhe kohës, së zhvillimit të ngjarjeve në një vepër dramaturgjike, gjithmonë duke iu referuar veprës **Toka jonë**, pavarësisht se nuk tregon një fakt fillestar pikënisjeje, autori shkruan se: *vetë faktet më diktuan vendin dhe kohën. Pra, ngjarjet do të vendoseshin në një fshat të Bregut të Matës, pikërisht në kohën kur po ndaheshin tokat, pra, kur po zbatohej Reforma Agrare*³. Cila fakteve u referohej autori? Në sa kemi parashtruar deri tani, fakte janë: vrasje, Bregu i Matës, pronar tokash, reformë agrare; gjithë të tjerat janë opinione e qëndrime. Fakt me këto tipare rezulton të jetë ajo që unë supozoj të jetë fara e dramës. Unë jam përpjekur ta lexoj mes rreshtash atë që shkruante autori mbi veprën tij dhe natyrisht nuk mund të më shpëtonte nga vëmendja një fragment, që i jep ngjyrë hipotezës së farës së dramës: *Ndodhte që, në bisedë e sipër, ndonjëri [prej fshatarëve] ia këpuste ndonjë parulle armiqësore, për të cilën edhe mund ta pësonte keq. [...] E dija që armiqte u kishin futur frikën duke u thënë, se komunistët për një fjalë të futin në burg*⁴. Ç'nevojë kishte të merrej me një fakt të tillë, në mos për të çliruar ndërgjegjen nga ajo që kishin bërë shokët e tij dhe që, autori e dinte mirë, pasi shkruan se Bregun e Matës e njihte deri diku edhe më përpara, por njohjen më të plotë e bëra pas dyzetë e nëntës, kur veja vazhdimisht me ekipet nga qendra për fushatat e ndryshme dhe probleme partie⁵?

Meqenëse drama merret me çështje të ndarjes së tokës, në vitin 1954, kur reforma agrare kishte mbaruar me kohë dhe kur duheshin ende edhe rreth gjashtë vjet të dilte ligji për kolektivizimin në kooperativa, hulumtova se çfarë duhet ta kishte shtyrë Jakovën, që pikërisht në këtë kohë, të shkruante një dramën me tematikë të shkuar, për një problem madhor si ai i caktimit të kufijve të tokave. Dramaturgjia nuk është letërsi e ngeshme, ajo ka funksion pragmatik dhe mesazhpërçues, ca më shumë dramaturgjia e agjit-propagandës,

¹ Jakova K. (1979), *Për dramaturgjinë... në ndihmë të autorëve të rinj*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia Qendrore e Krijimtarisë Popullore, fq. 119

² Jakova K. (1979), *Për dramaturgjinë... në ndihmë të autorëve të rinj*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia Qendrore e Krijimtarisë Popullore, fq. 120

³ Jakova K. (1979), *Për dramaturgjinë... në ndihmë të autorëve të rinj*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia Qendrore e Krijimtarisë Popullore, fq. 121

⁴ Jakova K. (1979), *Për dramaturgjinë... në ndihmë të autorëve të rinj*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia Qendrore e Krijimtarisë Popullore, fq. 33

⁵ Jakova K. (1979), *Për dramaturgjinë... në ndihmë të autorëve të rinj*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia Qendrore e Krijimtarisë Popullore, fq. 32

ndaj hulumtova pak mbi çështjet e shpronësimeve apo prekjës së kufijve tokësorë në këto vite. Sipas disertacionit *Çështja e pronësisë mbi sende të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë (vështrim historik)* të Besnik Mahos, më rezulton se ngjarja e vetme, që mund ta ketë ngacmuar në këtë kohë çështjen e prekjës e rivendosjes së kufijve tokësorë, është *Urdhëresa Nr. 4 e Këshillit të Ministrave*, datë 26.06.1954, *“Mbi administrimin dhe shfrytëzimin e kullotave kolektive”*, sipas së cilës, do të ricaktoheshin sipas nevojave të fshatrave kufijtë e kullotave¹. Siç kemi folur në kapitullin e *Ritualeve të pronës*, të prekje kufijtë, ishte njësoj si të luaje eshtrat e të vdekurve dhe se ato ndryshoheshin vetëm me hedhje guri, sëpate ose me gjakun e atij, që kishte luftuar për të ndryshuar kufirin. Kur tokat iu ndanë të varfërve menjëherë pas çlirimit, mund të ishte mbyllur një sy nga ata që kishin përfituar tokën kot, por tani nuk do të ishte më njësoj të prekje prapë kufijtë, sidomos kur përfitimet nuk ishin të dukshme për individët. Kështu që, përmes *Toka jonë*, përligjej jo vetëm prekja e kufijve të reformës agrare ‘45-‘46, por edhe çdo cenim i mëtejshëm i kufijve, duke e shuar kështu çdo pretendim mbi ligjin e vjetër, që po zëvendësohej forcërisht nga i riu.

Sipas *Historisë së letërsisë shqiptare të realizimit socialist*, një botim i Akademisë së Shkencave të vitit 1978, *Toka jonë* është vepra dramatike më me vlerë e kësaj periudhe, si për sa i takon idesë, ashtu edhe për nga thellësia e pasqyrimit realist të jetës². Kolë Jakova, duke pasur penë të mirë dhe mendje pjellore, ia doli mbanë ta strukturonte një dramë të agjit-propagandës si një pjesë të fuqishme propagandistike, që ngjallte emocione të forta, aq sa shuante logjikën analizuese, një jehonë që na ndjek pas edhe sot. Këtë të fundit e konstatova gjatë kohës, që kryeja anketimin në terren, kur njerëzit ngacmoheshin dhe fillonin të debatonin mbi mesazhet e dikurshme të veprës dhe sa të mira e sa të këqija buronin prej ngjarjeve të përmendura në vepër. Prej këtyre anketimeve, do të sjell vetëm pikëpamjen analitike të të dhënave dhe më pas do të krahasoj të dhënat e mbledhura me qëndrimin tim analizues. Duke pasur interes mbi mesazhin, që përcillte shfaqja teatrore, pyetja kryesore që bëra ishte: *Cili është thelbi i “Toka jonë”*? Në fakt, për shkak të përgjigjeve që kisha marrë para anketimit, kur pyesja për *Toka jonë*, po edhe pse vetë kisha një mbresë të tillë nga leximi i hershëm i veprës, kuptova që njerëzit kishin një perceptim për Tuç Makun, si bajraktar, ndaj këtë pikë e shtova enkas në anketim. Dua të sqaroj edhe se anketimi kishte një pikë shtesë *“Të gjitha mesazhet e përmendura”*, sepse për mua kishte rëndësi të veçantë të kuptoja, nëse kishte mesazhe që spikatnin apo nëse vepra nuk krijonte ndasinë e duhur të mesazheve kryesore, por rezultatet më treguan se shumica kishte marrë mesazhe të qarta e të shkëputura nga njëri-tjetri. Në Figurën 16 janë rezultatet e mesazheve, që kishin marrë njerëzit nga vepra dramaturgjike:

¹ Maho B. (2016). *Çështja e pronësisë mbi sende të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë (vështrim historik)*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Histori-Filologjisë, Departamenti i Historisë, Tiranë, Shqipëri, referuar më 02.11.2018, <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2017/05/Besnik-Maho.pdf> fq. 142

² Myftiu A., Shaplllo D., Siliqi D., Bullo J., Bihiku K., Kokona L. (1978), *Historia e letërsisë shqiptare të realizimit socialist*, Tiranë, Shqipëri: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, fq. 181

Cili është thelbi i "Toka Jonë"?




Figura 15 – Anketim mbi mesazhin që përcjell Toka jonë

Siç e shikoni pjesa më e madhe e të anketuarve, 26% e tyre¹, kanë marrë si mesazh “*Luftën ndaj bajraktarëve të vjetër*”, por Tuç Maku nuk është bajraktar dhe nuk përmendet kund si i tillë. Po si është e mundur kjo? Pikërisht, këtu hyn mjeshtëria e penës së Kolë Jakovës dhe njohuria e tij mbi terrenin për të cilin shkruante. Që të ishte bajraktar, Tuç Maku duhet të kishte fuqi të trashëguar politike në territorin ku zhvilloheshin ngjarjet (siç e kemi sqaruar në kapitullin e **Familjes**), por ai nuk e kishte një fuqi të tillë. Ai as si kryetar fisi nuk përmendet, por thuhet vetëm se kishte shumë toka dhe se të gjithë e kishin frikë. Në leksionet e regjisë së teatrit e të aktrimit ka një aksiomë, që e ruan personazhin nga skematizmi: “*Mbreti e luajnë shërbëtorët*”, pra mbreti nuk ka pse të ulërijë e të vrasë, që të tregojë sa i egër është, mjafton që gjithë të tjerët të flasin me frikë për të. Kështu, në një bisedë ku debatohet se janë bërë allishverishe me ndarjet e tokave sipas reformës, Meti, anëtari i partisë në terren, u thotë fshatarëve:

METI

*Ka ligje këtu. Kushdo që e shkel, e paguen shtrenjtë. Sot sundoni ju, e jo Tuç Maku, as Nikë Vuksani me shokë*².

Ja edhe shenjat e para të atribuimit të pushtetit ndaj Tuç Makut, (të cilat përsëriten vazhdimisht gjatë pjesës) kur në fakt, një i pasur nuk kishte pse të gëzonte pushtet, sipas kanunit. Pushtet nuk kishte pse të ushtronte as nëse ishte kryetar fisi, pasi siç kemi sjellë vërejtjen edhe Hezllakut te kapitulli i **Familjes**, edhe vetë fisi ka luhatje pasurie e fuqie, në varësi të urtësisë së prijësit të përkohshëm. Autori e ka gjetur diku tjetër fuqinë e Tuç Makut dhe të babait të tij:

SELIMI

Besa, edhe me gjak janë la këto fusha. Mjaft ç’ka vra baba e gjyshi i Tuçit për me i zaptue këto toka!

PALI

Pse, Tuçi jo?

SELIMI

*Tuçi ma me dorza. Ka dalë ma i zgjuet se baba e gjyshi i vet.*³

Siç e shikoni, personazhet aludojnë për egërsinë e fisit të Makëve, falë së cilës kanë grabitur tokat në fshat, por siç kemi parë edhe më herët në **Ritualin e pronës**, caktimi i kufirit me gjak brenda fshatit nuk ndodh, pasi në nyjën e pesëdhjetë e nëntë, neni 254 thotë: *Po u kapën për kufij vllazën, a kushrij, a fisi me fis, a katundi me katund, njiqind me u vra, veçse fiken, se kufijt nuk luhen. Pengjet e Pleqt do t’i shgatrrojn*⁴. Pra, toka me gjak zihet vetëm mes fshatrave, jo brenda tij, pra, ky është një pretendim që nuk rri.

¹ Duhet shtuar këtu edhe 11% që kanë zgjedhur “*Të gjitha mesazhet e përmendura*”

² Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 151

³ Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 154

⁴ Gjeçovi Sh. (1933) *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Shkodër, Shqipëri: Shtypshkronja françeskanë, fq. 38

Atëherë, Tuç Maku qenka njeri vërtet i lig, nga i cili duhet të ruhesh. Në dialogun mes Vatës e Tuçit tregohet dinakëria e Tuç Makut për ta lidhur Vatën pas sekretit të vrasjes së një partizani. Pra, fuqia e Tuç Makut qëndron në faktin se është i aftë të ngrejë kurthe dinake, prej të cilave, me sa duket, më së shumti ka vuajtur Lokja. Kur Murrashi vjen në fshat dhe përballet me Tuç Makun, ai e akuzon atë se ka ngritur një thashethem, që ka prishur marrëdhëniet e familjes së tij, por Tuç Maku mbrohet se nuk e ka hapur ai thashethemin për pandershmërinë e Lokes¹. Në fakt, thashethemi është boshti i veprimit dramatik të kësaj vepre dhe unë nuk di ta shpjegoj se si vetëm 7% e të anketuarve kanë marrë mesazhin: “*Pasojat e thashethemeve*”². Duhet të ndalem pak te thashethemi, sepse ai ka rëndësi të veçantë për këtë vepër dhe rrethanat e saj.

Popullsitë e përqendruara në zona të caktuara banimi (jo nomade) dhe sidomos ato që janë më të izoluara se të tjerat, të cilave u duhet të jetojnë dekadë pas dekade me njëri-tjetrin, pavarësisht nëse u pëlqejnë apo jo anëtarët e tjerë të komunitetit, kanë një tendencë ta fshehin mërinë, të mbajnë turinj dhe të përfshihen në sulme të tërthorta si vandalizmi dhe thashethemi³. Antropologët e shohin thashethemin si një fenomen socio-kulturor dhe ndaj thashethemit ka tri qasje: funksionale, transvepruese dhe simboliko-bashkëvepruese. Qasja funksionale u thjeshtëzua nga Maks Glukmani (*Max Gluckman*), që thotë se thashethemi është një proces i sanksionuar, fakt social i përcaktuar nga kultura ku zhvillohet, i cili ka rregulla zakonore dhe funksion të rëndësishëm. Thashethemi ndihmon në ruajtjen e unitetit, moralit dhe historisë së grupit, pasi thelbi i thashethemit sjell vlerësim dhe konfirmim të vazhdueshëm moral të sjelljes, përballë pritshmërive zakonore. Qasja transvepruese e mbështetur nga Robert Pejni (*Robert Paine*) nuk parashikon unitet dhe ekuilibër të grupit, por për të thashethemi është në shërbim të atij që e krijon, për të manipuluar rregullat kulturore, për të mbrojtur interesat vetjake në fuqi, miqësi, rrjet apo të mira materiale, duke e përthyer rendin moral, për qëllime personale. Qasja simboliko-bashkëvepruese duket se e përmbys këndvështrimin e grupit apo të individit dhe Xhon Bërd Hevilendi (*John Beard Haviland*) e Samuel Heillmeni (*Samuel Heilman*) thonë se thashethemi është një proces meta-kulturor, përmes të cilit individët hetojnë dhe diskutojnë së bashku rregullat, sipas të cilave jetojnë. Gjithsesi, thashethemi nuk është kurrë pa funksion⁴.

Po ta hulumtojmë me kujdes, thashethemi i ngritur nga Tuç Maku, duke e ditur se sa i qëndrueshëm është morali i grupit përballë individit, ka një qasje funksionale dhe ajo që ka ndodhur me Loken, e provon më së miri këtë: duke e përzënë Loken e dyshuar për nder, grupi ricakton rendin e thyer dhe vijon të ruajë normat morale. Në **Kanunin e Dibrës**, shpifja paguhet me gjak dhe marrja e jetës për ta shlyer atë është veprim i nderuar, kurse në **Kanunin e Lek Dukagjinit**, nuk ka penalitete për thashethemin: *Fiala mort s’ban. Goia s’qet*

¹ Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 182

² Duhet shtuar këtu edhe 11% që kanë zgjedhur “*Të gjitha mesazhet e përmendura*”

³ Barnard A., Spencer J. (red), (2010), *The Routledge Encyclopedia of Social and Cultural Anthropology, 2nd edition*, Okson, Britani e Madhe: Routledge (Taylor & Francis e-Library version), fq. 600-601

⁴ Barnard A., Spencer J. (red), (2010), *The Routledge Encyclopedia of Social and Cultural Anthropology, 2nd edition*, Okson, Britani e Madhe: Routledge (Taylor & Francis e-Library version), fq. 337-338

kënd në giak. Fjala e gojës s'eme hin në vesh të tjetrit, e i treti e përdoron për rrënim të kuej, un rri e tallem. Fjala e eme në shkaktotë vrasë të përgjegjme un rri e zgërdhihem, nuk munda të më kapë kush për punë të liga, qi shkakttoi goja e eme. A fola a s'fola, goja nuk vulosë gja. Fjalët e stërkqive kanuja s'i merr para sysh¹. Kështu, Kolë Jakova ia atribuon fuqinë Tuçit te aftësia që ka për kurthe e thashetheme dëmtuese. Megjithatë, fuqia që buron prej thashethemit të Tuçit ka një kontradiktë, kur përmendet se ai përdor mjete financiare për ta ushqyer atë:

MURRASHI

Ku e di ti se nana jonë ishte e pandershme?

TUÇI

Atë s'e di vetëm unë, as nuk e kam shpikë unë. Pyet katundin ma mirë.

LOKJA

Të pyesim katundin, o bir. Dëshmitarët e vjetër kanë nisë t'i hanë fjalët.

TUÇI

I hanë fjalët tani se kanë frikë Murrashin.

LOKJA

Nuk ta kanë frikën ty, o gjarpën. Të kishin frikë atëherë kur u jepje pare dhe i mësoje të shpifnin para fëmijëve të mi, që t'i largoje prej meje. Pyet Zog Dodën, atë tarallakun. Ai të tregon sot se sa pare ka hangër prej teje për me dalë dëshmitar në rrenë.²

Po paratë e paguara, nuk e bëjnë marrësin t'i trembet Tuçit, përkundrazi, Tuçi duhet të kishte frikë se mos dilte e vërteta në shesh. Kështu që këtu ka një mekanizëm të qëllimshëm, për të mbështetur teoritë marksiste se individët, që zotërojnë mjetet e prodhimit dhe pasurinë janë burimi i së ligës, pasi shfrytëzojnë dhe shtypin ata që nuk kanë pasuri³. Këtë me mjeshtëri Kolë Jakova e lidh, kur lë të nënkuptohet se për të vlarë burrin e Lokes ai ka paguar Gjini Keçin dhe pastaj Gjini Keçin e ka vlarë, duke paguar dikë t'i marrë gjakun⁴. Pra, ja se si e lidh autori të keqen individuale të një njeriu me fuqinë e parasë, duke e bërë që ta perceptojmë Tuçin si burim fuqie. Në fakt, kjo përkonte edhe me udhëzimet datës 6 prill 1952, dalë nga *Kongresi II i PPSH*, sipas të cilave, *detyra e Partisë është që të kuptohet mirë se problemi i luftës së klasave përmban në vetëvete luftën ekonomike, politike dhe ideologjike. Të mbahet parasysh që nuk jemi në fazën e likuidimit të kulakëve, por në fazën e kufizimit ekonomik e të izolimit politik të tyre dhe kjo duhet të bëhet në mbështetje me fshatarët e varfër e në aleancë me fshatarët e mesëm. Të zhduken*

¹ Gjeçovi Sh. (1933) *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Shkodër, Shqipëri: Shtypshkronja françeskane, fq. 59

² Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese "Naim Frashëri", fq. 182

³ Marx, K., Engels, F. (2008). *The Communist Manifesto*. London: Pluto Press, fq. 90

⁴ Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese "Naim Frashëri", fq. 184

të gjitha gabimet lidhur me zbatimin e direktivave të Partisë, duke mos kaluar në likuidimin e kulakëve, duke evituar me çdo kusht cilësimin e fshatarëve të mesëm si kulakë¹. Kjo justifikon edhe pse Tuçin në fund Lokja nuk e vret, po ia dorëzon Togërit.

Sipas studiuesit Papagjoni, konflikti i pjesës zgjidhet sipas skemës së paraparë: Tuç Maku bëhet kriminel, nxit Vatën për të vrarë Murrashin dhe më pas kapet dhe arrestohet². Por, që Murrashin e ka vrarë Tuçi përmes Vatës, është thjesht perceptim, i ngjashëm me perceptimin popullor të gjyqeve publike komuniste. Në vepër, Vata nuk e pranon që e ka vrarë Murrashin për Tuç Makun, në gojën e Vatës fjalët i vë Lokja dhe e konfirmon pa prova Togëri³. Njëjtë edhe Tuç Maku nuk e pranon, që ta ketë çuar Vatën për të vrarë Murrashin, as para provokimit të Lokes. Tuç Maku pranon vetëm fundin e tij, kur e lidhin partizanët dhe thotë: “*Më erdhi fundi*”, që parë me logjikë të ftohtë dhe me informacionin se si shkonin gjyqet popullore në fillimet e komunizmit, mund të merret edhe si konstatim i një situatë, ku ai e di që s’do të dalë dot fitimtar, edhe sikur të ketë të drejtë⁴. Se ç’lloj gjykimi do të pësonte Tuçi, na e konfirmon edhe Dilaver Dilaveri, i cili në një analizë të pjesës në vitin 1969, na sjell këndvështrimin e kohës dhe mesazhin e marrë nga publiku: *Pas vrasjes së Murrashit, Tuçi kapet dhe i dorëzohet gjyqit të popullit për t’u dënua*⁵.

Por nuk duhet të harrojmë se edhe mesazhi, që përcjell autori me këtë pjesë të paqëndrueshme nga pikëpamja faktike e historisë, ka vetë funksionin e një thashethemi me qasje transvepruese, pasi e përthyen rendin moral të publikut, për të mbërritur qëllimet personale propagandistike të autorit, madje pa u dënua as vetë nga zakonet e maleve pse po shpif. Kështu, i mbështetur edhe nga botëkuptimi se komunistët janë “*të mirët*” dhe pronarët “*të këqijtë*” apo antikomunistët “*mizorë*”, pa e thënë askund, ai arrin të bëjë njësh në mendjen e publikut një pronar të mbrapshtë tokash, i cili ka vetëm fuqi ekonomike, me një njeri me pushtet politik, që publiku e percepton si bajraktar dhe për pasojë si rendin e vjetër e të mbrapshtë.

Nuk janë të paktë edhe 24%⁶ e të anketuarve, që kanë marrë si mesazh nga vepra “*Të mirat e reformat agrare*”. Në fakt, po ta shohësh me kujdes dramën, shumë prej fshatarëve që flasin, janë fshatarë pa tokë dhe ia atribuojnë partisë marrjen e saj:

PALI (këndon)
O Parti ta puthsha ballin
Se sa mir’ ma dihte hallin,

¹ Hoxha E. (1972) *Rezolucion i Kongresit II të Partisë së Punës të Shqipërisë - Për raportin Mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë: Mbi punën e Partisë në fshat* botuar në *Dokumente kryesore të Partisë së Punës të Shqipërisë 1949-1956*, Vëll. II, Tiranë, Shqipëri: Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH, fq. 281

² Papagjoni, J. (2011). *Historia e teatrit shqiptar*. Tiranë, Shqipëri: Qendra e Studimeve Albanologjike, fq. 220

³ Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 198

⁴ Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 202

⁵ Dilaveri D. (1969). *Toka jonë* botuar në *Drama jonë - përmbledhje artikujsh kritikë*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, fq. 136

⁶ Duhet shtuar këtu edhe 11% që kanë zgjedhur “*Të gjitha mesazhet e përmendura*”

*Un' për ty e falsha djalin
Po dëgjoni, more shokë
Erdhi dita t'marrim tokë
N'votrat tona t'jemi zot.
Këto toka la me lot,
T'i gëzojm' përjetë e mot¹.*

Fshatari pa tokë nuk është një fenomen i zakonshëm në veri, ku i tillë ishte vetëm ai që shkëputej nga trangu i fisit me dëshirë: *me i u mbushë menja ndonjënit ndër dielm me u da prej t'et, del pa pjesë e pa gja²*, sepse edhe kur djali ishte i mbrapshtë, ai nuk dilte pa pronë: *kryekcyemin me e da shpijet me pjesë, qi i përket, për me shporrë shnerzimin e rrezikun³*. Por bujku i varfër ishte një figurë e rëndësishme për ideologjinë komuniste në Shqipëri, pasi me të identifikohet *“proletariati”*, klasa e punëtorëve modernë me pagë, të cilët duke mos patur vetë në dorë mjetet e prodhimit, ishin të detyruar të shisnin fuqinë punëtore për të jetuar⁴. Mirëpo, Shqipëria e pas Luftës së Dytë Botërore nuk kishte të tillë proletariat, pasi vendi nuk kishte hyrë ende në revolucionin industrial, ku kishin hyrë Evropa dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fund të viteve 1800, kur Marks i dhe Engelsi shkruan **Manifestin komunist**. Për këtë arsye Meti, anëtar i partisë në terren, nuk është bujk, por punëtor, si arketip i proletariatit, që do të ndryshojë edhe mentalitetin në fshat:

METI

Unë nuk kam qenë ndonjëherë bujk. Kam punue sapun në fabrikën e Hotit në Shkodër. Jam shtypë edhe unë si ju, po gëzimin e tokës nuk e njoh, si e njihni ju. Sa bukur do të jetë, kur të vijë njëherë dita e të punoni si vllazën pa gardhiqe në këtë fushë të madhe⁵.

Meti transmeton tiparet e proletariatit, klasës së shtypur sipas parimeve komuniste, te bujqit. Po, përtej gjithë varfërisë që prodhuan dy luftërat botërore, nuk është e lehtë të zhbësh strukturën shoqërore fisnore, sepse, siç kemi përmendur Deniçin në kapitullin e **Nderit si kod i trashëgueshëm kulturor**, është pikërisht struktura e familjes agnatike, ajo që ruan mjetet e kursyera të jetesës. Autori, përmes qasjes ekonomike, që karakterizon mbarë teorinë komuniste, përpiqet të fusë në vepër një koncept hibrid të familjes së vjetër me doket e saj zakonore dhe të familjes së re bërthamë, duke e imponuar këtë të fundit, edhe pse vetë parimet komuniste, rrëzohen përballë familjes së vjetër fisnore. **Manifesti komunist** flet për borgjezët, si klasa e kapitalistëve

¹ Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 153

² Gjeçovi Sh. (1933) *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Shkodër, Shqipëri: Shtypshkronja françeskane, fq. 23

³ Gjeçovi Sh. (1933) *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Shkodër, Shqipëri: Shtypshkronja françeskane, fq. 8

⁴ Marx, K., Engels, F. (2008). *The Communist Manifesto*. London: Pluto Press, fq. 33

⁵ Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 154

modernë, që zotërojnë mjetet e prodhimit në masë¹, të cilët në mungesë të revolucionit industrial në Shqipëri i binte të ishin krerët e fiseve, që zotëronin pronat e fisit. Në manifest thuhet se borgjezët, ia kanë çjerrë familjes vellon sentimentale dhe e kanë tkurrur në një marrëdhënie, që lidhet thjesht me paranë². Në fakt, **Toka jonë** provon krejtësisht të kundërtën dhe kjo dallon edhe më mirë në përshtatjen për film të vitit 1964 të dramës **Toka jonë**, me skenar të Peçi Dados dhe regji të Hysen Hakanit³, ku Vata nxiton të martohet me Filen, edhe duke thyer zakonet, sepse si familje e re, do të përfitonin tokë nga reforma agrare⁴. Pra, duke qenë se çdo kurorë meritonte dynymët e saj, ishte pikërisht qasja ekonomike dhe lidhja me paranë, ajo që nxiste edhe më shumë dëshirën për ta çjerrë vellon sentimentale të familjes tradicionale dhe për ta thyer boshtin e fisit agnatik, duke i shpërndarë gjymtyrët nga familja tradicionale, ku disa breza jetonin nën të njëjtin kulm e me ekonomi të përbashkët. Disa herë përmendet në vepër kjo luftë për të ndryshuar strukturën zakonore:

MURRASHI

*Edhe pse jam ma i vogël, në shtëpinë tonë do të bahet si them unë.
Këtu nuk flet Murrash Gjoka, po flet Partia e ne të gjithë jemi të Partisë⁵.*

apo Murrashi kur akuzon Tuçin se i ka vrarë babanë:

MURRASHI

Simbas zakonit, ti e do plumbin prej nesh e jo prej vllazënve të Gjini Keçit. Por në shtëpinë time nuk këqyret zakoni i vjetër, por ligji i pushtetit, që të dha të shtymer⁶.

ose kur i thotë Lekës, se nuk duhet të hakmerret për gjakun e babait, duke e vrarë vetë Tuçin:

MURRASHI

Hiqu atij mendimi, Lekë, se të bie ma mirë. Sot nuk kemi nevojë ta bajmë gjyqin vetë. E di zakonin edhe unë; por Partia na mëson të tjera. Ato zakone e sollën Tuçin në këtë ditë⁷.

¹ Marx, K., Engels, F. (2008). *The Communist Manifesto*. London: Pluto Press, fq. 33

² Marx, K., Engels, F. (2008). *The Communist Manifesto*. London: Pluto Press, fq. 37

³ Kjo është një përshtatje e dobët e veprës dramaturgjike, skematike dhe me marifete në akte pronësie, që nuk ekzistojnë në veprën origjinale, duke e shmugur fokusin nga mesazhet kryesore. Druaj se një pjesë e të anketuarve që i janë përgjigjur në masën 13% mesazhit: “Probleme pronësie” janë ndikuar nga filmi, ashtu si edhe një pjesë e 11%, që janë përgjigjur: “Të gjitha mesazhet e përmendura”, pasi vetëm në film është i fortë ky mesazh. Në pjesën dramaturgjike është si një nënmesazh, që prek vetëm ndjeshmërinë e atij që njih problemet e cenimit të pronës.

⁴ N.d. (N.d.), “Toka jonë” referuar më 02.11.2018 <http://www.aqshf.gov.al/arkiva-kerko-1.html?movie=5&category=1&title=Toka%20jon&screenwriter=&description=> (min. 22:29-22:41)

⁵ Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 190

⁶ Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 184

⁷ Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 189

Sidomos kjo e fundit është totalisht e pabazuar, pasi Tuçi nuk ishte njeri i keq prej zakoneve, përkundrazi ai ishte rrekur sa e sa herë t'i shkelte ato e nuk kishte jetuar sipas nderit, që i lypte zakoni:

LOKJA

Nderi yt! E dinë plot gra, shoqet e mia, ç'kanë heq nga ky nderi yt¹.

Pra, pretendimet e Murrashit se Tuçi është një njeri i keq, sepse jeton sipas zakonit, që duhet ndërruar me ligjet e reja, sepse këto zakone i bëjnë njerëzit të mbrapshtë, nuk qëndron. Megjithatë, nga anketimi del se 19%² e popullatës së intervistuar e ka marrë mesazhin e “*Zhdukjes së mbeturinave kanunore*” nga vepra dhe kjo nuk është një shifër e vogël.

Pavarësisht përpjekjeve për të nxirë ligjet zakonore, këto norma ishin të rrënjosura kulturalisht prej shekujsh dhe, edhe leverdia ekonomike e përfitimit të tokës prej çdo kurore, nuk mund ta justifikonte cenimin e kufijve të tokave, që ishte barabar me trazimin e varreve. Atëherë, autori përdor disa herë në vepër, një truk të fitimit të tokës me gjak, duke bërë një transferim ideologjik të zakoneve të të parëve, në të tashmen politike:

LOKJA

Murrashit i qitën sytë shkëndija: “Tokën e kemi fitue me gjakun e shokëve”³.

apo:

LOKJA

Unë u thashë këtyne: këto pare i kam fitue me thoj të duerve. Ia kam heq gojës dhe i kam grumbullue, vetëm që t'ju blija një copë tokë. Mirëpo ju dolët ma të zgjuet e ma trima. Tokën e fituet me gjak⁴.

apo mbyllja:

LOKJA

*Po zbardhon. E para ditë që Murrashi nuk e sheh. (Shikon fushën)
A do t'i ndani tokat, Met, ashtu si thoshte Murrashi?⁵*

METI

Po nanë, të dielën patjetër, e bash ashtu si thoshte Murrashi.

¹ Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 183

² Duhet shtuar këtu edhe 11% që kanë zgjedhur “*Të gjitha mesazhet e përmendura*”

³ Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 167

⁴ Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 180

⁵ Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 197

LOKJA

Murrash i nanës! Sa e bukur asht kjo fusha jonë, vendi ynë, toka jonë¹.

Caktimi i kufijve të rinj nga ana e njerëzve të partisë, justifikohet me caktimin e kufirit me gjak, që në këtë rast është gjaku i atyre, që vdiqën kundër pushtuesve dhe me parimin “ose me mua, ose kundër meje”, u vishnin edhe anti-komunistëve ose pronarëve të ligjshëm të tokave edhe tiparet e liga të pushtuesve, në rast se nuk pranonin këtë “kufi të ri gjaku”.

Në fakt, kur e fillova analizën, nuk isha plotësisht e bindur në hipotezën, që Kolë Jakova e shkroi pjesën në lidhje me vendimin e lëvizjes së kufijve të kullotave e fshatrave, mirëpo pak para mbylljes Togeri i thotë Lokes:

TOGERI

Ti kujton se Murrashin e vrau vetëm Tuç Maku? Jo, nënë! Kapja e Tuçit do të lëshojë dritë mbi gjakësorët e vërtetë të Murrashit. Ka mjaft nga ata që u djeg sot puna e tokës. Nesër atyre do t’iu djegë çdo ligj e urdhëresë e pushtetit tonë. Do të ketë prapë nga ata, që do të kërkojnë të vrasin përsëri Murrashin².

që duket se e vërteton tezën e justifikimit të lëvizjes së kufijve të tokës në të shkuarën, në të tashmen e në të ardhmen. Dhe si për ta përligjur atë për të cilën fola në hipotezën e farës së dramës, një dozë frike ndaj pushtetit të ri, si nga ata që e pësojnë, ashtu edhe nga ata që e ushtrojnë, përshkon gjithë veprën, veçanërisht në gojën e Murrashit, si për të legjitimuar çdo lëvizje ligjore e zbatuese të dhunshme të pushtetit, ndaj atyre që do ta kundërshtonin atë.

Ajo që më bën më shumë përshtypje me veprat artistike të realizmit socialist, shkruar nën thjerrën e agjit-propagandës, është se ato vazhdojnë të ndiqen edhe sot nga një numër i madh njerëzish. Për disa është nostalgjia ndaj përftimeve të regjimit të shkuar, po për të tjerët? Siç thamë në përkufizimin e agjit-propagandës në art, një mesazh i besueshëm politik mund të përcillet vetëm prej një loje të mirë të aktorëve dhe rrethanave sa më të besueshme të tyre. Pikërisht këtë desha ta vë në provë edhe me anketimin.

Të pyetur se çfarë ju ka mbetur më shumë në mendje nga **Toka jonë**, 45% janë përgjigjur: “Personazhet (loja e aktorëve)” dhe ndiqet nga: “Batutat e aktorëve (të shkëputura nga konteksti)” (Figura 17). Pra, fuqia e penës së Kolë Jakovës qëndron në mjeshtërinë e portretizimit të pasur të personazheve kryesore, që pastaj janë mishëruar me mjeshtëri nga aktorët, sidomos figura Tuç Makut, e shtruar në ligësinë që mbart brenda, luajtur nga Loro Kovaçi, rol për të cilin Josif Papagjoni shkruan: *ai mbërriti në kulmin e vet artistik, duke krijuar tipin e njeriut tinëzar, dhelparak e lakmiqar i panginjur, me një egërsi e urrejtje të fshehtë, që të vret pas shpine e pastaj të bujt në shtëpi e të bën ngushëllimet³*. Fatkeqësisht, unë nuk e kam mbërritur ta shoh vënien skenike të

¹ Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 203-204

² Jakova K. (1986). *Toka jonë* botuar në *Vepra letrare 2*, Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, fq. 203

³ Papagjoni, J. (2011). *Historia e teatrit shqiptar*. Tiranë, Shqipëri: Qendra e Studimeve Albanologjike, fq. 220

Nga "Toka Jonë" ju ka mbetur në mendje...




Figura 16 – Anketim mbi fuqinë e elementeve të Toka jonë

kësaj pjese dhe nuk kam mundur të gjej as regjistrim televiziv të saj, por me sa kam parë nga roli i Tuç Makut në filmin ***Toka jonë***, luajtur po nga Loro Kovaçi, mund të them se ai ka ndërtuar një personazh me shumë ngjyrime e nënshtresa në veprimet e batutat e tij, edhe pse personazhi i filmit, ashtu si përgjithësisht përshtatja filmike, është shumë më skematik e i varfër se ai i tekstit dramaturgjik. Pra, ja se si ka arritur Kolë Jakova të përcjellë me mjeshtëri mesazhe të dukshme e të padukshme, me një vepër të agjit-propagandës, gjurmët e së cilës nuk janë shlyer ende sot.

